



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 28.01.2019, ora 10:30

**Drejton mbledhjen:**

**Petrit Vasili – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 14.11.2018, 21.11.2018, 04.12.2018 dhe 12.12.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit.

**Marrin pjesë:**

Petrit Vasili, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Klotilda Bushka, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Floida Kërpaçi, Halim Kosova, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

**Mungojnë:**

Bardh Spahia, Roland Xhelilaj, Vangjel Tavo dhe Grida Shqina.

## HAPET MBLEDHJA

**Petrit Vasili** – Miredita!

Hapim mbledhjen. Së pari, në bazë të vendimit të marrë në seancën e fundit plenare, zonja Klodiana Spahiu caktohet zëvendëskryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Zoti Arben Kamami caktohet sekretar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Po me vendim të kësaj seance, zonja Klotilda Bushka largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe caktohet anëtare për Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Këto ishin disa njoftime, që lidhen me përbërjen e komisionit.

Hyjmë te çështjet e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 14.11.2018, 21.11.2018, 04.12.2018 dhe 12.12.2018.

Kush ka ndonjë vërejtje ose ndonjë plotësim për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohe.

Bazuar në programin e punës së kalendarit të miratuar në seancë, në komision nuk janë të depozituara projektligje, që kanë nevojë për shqyrtim nga komisioni, qoftë në cilësinë e komisionit përgjegjës, qoftë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Kjo është një hapësirë shumë e rëndësishme jona, e cila mundëson që komisioni të merret me disa çështje të tjera dhe që kanë sensibilitet të lartë shoqëror, që kërkojnë vëmendjen e të gjithë komisionit tonë.

Doja t'ju sillja në vëmendje që, përpara se të shkojmë te çështjet e tjera, duhet të marrim një vendim për një nismë deputeti. Ka filluar shqyrtimi me komisionin në sesionin e shkuar dhe nisma ka mbetur pezull.

I kam kërkuar Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi, të zgjidhë me grupin parlamentar të maxhorancës qëndrimin ndaj kësaj nisme. Ju e dini, se e keni shqyrtuar atë kohë, nisma ka mbetur pezull me kushtëzim.

Procedura parlamentare nuk parashikon nisma me kushtëzim, pra që ajo duhet të mbahej pezull në rast se Ministria e Shëndetësisë do të sillte në ligj përkatës, që do të vinte brenda muajit dhjetor. Për këtë ka dy rrugë: ose për nismën e deputetit Vullnet Sinaj, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/55 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar”, komisioni do të marrë një vendim dhe do të vazhdojë shqyrtimin e nismës, sikurse ajo është

paraqitur, ose të ftohet deputeti propozues dhe ta tërheqë nismën, sepse komisioni dhe Rregullorja e Kuvendit parashikon që nisma e paraqitur të shqyrtohet dhe të çohet përpara. Me vullnetin pozitiv apo negativ të deputetëve, kjo është çështje që nuk ka lidhje me thelbin.

Ju e kuptoni fare mirë që po mbajmë pezull një nismë në mënyrë ekstraprocedurale, se do të vijë një nismë, kur ajo të miratohet dhe në rast se nuk miratohet, nisma pastaj do të bëhet aktive. Kjo na vë në një mungesë serioziteti procedural. Kështu që po ia njoftoj komisionit...

E thashë, për këtë gjë i jam drejtuar me letër edhe zotit Ruçi, në mënyrë që të zgjidhet kjo çështje dhe ne të marrim një pozicion.

Në qoftë se nisma tërhiqet nga deputeti, shumë mirë, është vendimi tij. Në rast të kundërt, futemi në shqyrtimin e saj dhe, në rast se biem dakord, nisma shkon për vlerësim në qeveri për faturën financiare, siç është procedura.

Nuk dua të zgjatem më tej me këtë çështje.

**Klodiana Spahiu** – Mundem?

**Petrit Vasili** – Po, patjetër.

**Klodiana Spahiu** – Ne e shqyrtuam nismën e deputetit. Ditën që është bërë mbledhja për paraqitjen e nismës së deputetit kanë qenë edhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale. Në fakt, aty u mor një vendim, që brenda një afati kohor shumë të shkurtër, meqenëse ligji do të vinte i ri dhe në ligj përfshihej edhe propozimi i deputetit, i cili u konsiderua si një propozim shumë i drejtë nga të gjithë anëtarët e komisionit, si dhe nga përfaqësuesit ministrisë...

Sugjeroja që të gjithë bashkë t'i bëjmë një kërkesë tjetër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, se ndoshta projektligji mund të jetë gati. Me aq sa jam konsultuar me to, projektligji është gati. Në qoftë se ju do të jeni dakord (edhe Kryetari i Kuvendit), nëse është përfunduar gjithçka, mund të futet me procedurë të përshpejtuar, sepse nuk vura re që projektligji të ishte në kalendarin e ardhur deri tani.

**Petrit Vasili** – Zonja Spahiu, në mbledhjen e komisionit (po i referohem asaj që është thënë, jo çfarë them unë), zëvendësministrja, Ardiana Jaku, që ka qenë në emër të ministrisë, ndonëse po jua them se nga pikëpamja procedurale, në momentin kur deputeti shpreh nismën e tij, nuk ka nevojë të jetë ministria përkatëse... Kjo është një shthurje procedurale, pasi në momentin e paraqitjes së nismës, deputeti ia paraqet atë komisionit dhe komisioni shqyrton çështjet që ai ngre në mënyrë themelore dhe mjaftohet aty, pa e votuar. Këtë thotë Rregullorja. Në rast se komisioni ka nevojë, e thërret ministrinë më pas për të organizuar dëgjesa, por kjo vjen vetëm mbasi nisma dakordësohet, miratohet dhe shkon në qeveri për vlerësim të faturës

financiare (nëse ka). Po ju them atë që thotë procedura, se jashtë procedurave, ju e dini, unë nuk dal.

Atë ditë është thënë: “Ne kemi parashikuar që brenda muajit dhjetor ky ligj të jetë mbi tavolinat tuaja për ta parë dhe për të marrë një vendim.”

E gjithë kjo nuk ka të bëjë asgjëkundi me procedurën. Unë po ju them të kthehemi në procedurë normale. Kjo është një gjë që nuk kënaq ndonjë merak timin, por vetëm e vetëm për të qenë në respekt të kësaj...

Megjithëse është komplet jashtë procedurave, se nuk e kemi një ligj të tillë, problemi qëndron këtu: nëse është akoma konsistente ideja e deputetit, të planifikojmë të votojmë për këtë çështje, që të shqyrtohet nga qeveria dhe ajo të na japë faturën financiare. Në rast se deputeti dhe ju jeni konfidentë, në sensin që ministria ka një nismë të tillë që e shteron këtë, deputeti tërheq nismën dhe në vazhdojmë punët tona. Kaq.

Në këtë pikë besoj se nuk kemi çfarë të diskutojmë.

**Klodiana Spahiu** - Shumë e drejtë.

Brenda disa ditëve patjetër që do të marrim një vendim.

**Petrit Vasili** – Dakord.

Kemi disa çështje të bartura lidhur me kalendarin dhe pastaj do të vazhdojmë me propozimet.

Për kalendarin, propozim i mundshëm dhe i domosdoshëm është organizimi i disa nismave përkatëse, që kanë të bëjnë me dëgjesat.

Një dëgjesë e shtyrë dhe e pakryer (ka ardhur vetëm një informacion me shkrim, por nuk është kryer dot dëgjesa, pasi ministrja e Shëndetësisë nuk ka qenë e disponueshme për shkak të aktiviteteve apo agjendës së saj) ka qenë për skemën e ndihmës ekonomike dhe asistencën sociale, e kërkuar nga deputetja Grida Duma.

Meqenëse është një nismë e bartur, pra e pakryer, propozoj të jetë pjesë e kalendarit të kësaj jave dhe të javës tjetër, sepse praktikisht këto dy javë janë javët e punës që mund të parashikojmë për këtë kalendar 3-javor.

Së dyti, propozoj të organizohet një dëgjesë urgjente, brenda ditës së mërkurë, vetëm me Ministrinë e Shëndetësisë, për çështjen që ka shkaktuar ndjeshmëri të lartë publike, për urdhrin e nxjerrë nga Urdhri i Stomatologut për tarifat në shërbimin stomatologjik.

Së treti, një dëgjesë tjetër, e cila do të organizohet javën tjetër, sepse do të aranzhohen edhe agjendat e ministrisë për t’i përballuar, lidhet në mënyrë të veçantë me problemet e fruthit. Është një situatë që shoqëron Shqipërinë prej një viti e ca. Personalisht, jam përpjekur të tërheq vëmendjen e ministrisë dhe të opinionit publik për situatën që do të agravohej. Për fat të keq,

situata është agravuar. Për fat të keq, ka edhe viktimë. Natyrshëm, opinioni kërkon (natyrisht, nëpërmjet raportimit merren edhe informacione më të plota) edhe këshilla për këtë çështje. Është një çështje që ka ndjeshmëri të lartë publike dhe kërkon një qëndrim nga ne.

Njëherazi, kemi një nismë tjetër për kancerin, e cila lidhet me dy evente të mëdha. E ka propozuar zëvendëskryetarja, zonja Spahiu. Kjo nismë lidhet me dy data, që kanë të bëjnë me javën e parandalimit të kancerit të qafës së mitrës, së pari, që shtrihet në periudhën 22-28 janar (e kam fjalën si javë, nga pikëpamja formale) dhe 4 shkurtin, që është Dita Botërore Kundër Kancerit.

Meqenëse data 28 pothuajse u ezaurua, mendoj që të dyja këto çështje t'i trajtojmë në një dëgjese të përbashkët, ku të trajtojmë edhe kancerin, si pjesë të strategjisë së madhe, edhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Kjo na vendos në një normalitet, sepse, në fund të fundit, kanceri i qafës së mitrës është një problematikë e madhe dhe shumë e ndjeshme, brenda fushës së madhe të kancerit. Kështu që ne mund t'i ezaurojmë të dyja këto çështje në një dëgjese të vetme. Meqenëse të gjitha këto që përmendëm kanë lidhje me Ministrinë e Shëndetësisë, me përjashtim të seancës dëgjimore me Urdhrin e Stomatologëve për tarifat, që është më e qartë dhe më e thjeshtë, nëse do të kemi dakordësi, le t'i planifikojmë për ditën e hënë, të martë dhe të mërkurë të javës tjetër sipas gatishmërisë që ka Ministria e Shëndetësisë dhe njerëzit që ajo do të dërgojë. Do të jenë tri ditë të njëpasnjëshme, sepse mbaron koha e kalendarit 3-javor dhe do të duhet të mbledhemi për të miratuar një kalendar tjetër. Këto janë propozimet e mia për axhendën e mundshme dhe kalendarin për këto 3 javë.

Për çfarëdolloj diskutimi, fjala është për ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër.

**Orjola Pampuri** – Meqenëse do të rishikojmë propozimet për kalendarin dhe ka një propozim për të bërë një dëgjese për ditën botërore kundër kancerit, mendoj se duhet të biem dakord për datën, sepse më duket që parimisht u vendos.

**Petrit Vasili** – Janë propozuar dy ditë, por se kur do t'i bëjmë, kjo varet.

**Orjola Pampuri** – Këmbëngul që dëgjesën ta bëjmë vetëm me ministren, sepse është një çështje delikate. Për sa u përket sëmundjeve tumorale, ne kemi pasur problematika duke filluar nga mungesa e medikamenteve, ndaj propozoj që dëgjesa për ditën botërore kundër kancerit të bëhet vetëm me ministren dhe jo përfaqësues të tjerë nga Ministria e Shëndetësisë. Ky është propozimi im.

**Petrit Vasili** –Faleminderit! Ka diskutim tjetër?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zonja Spahiu.

**Klodiana Spahiu** – Mendoj se shqetësimi që ngriti kolegia është i drejtë. Meqenëse isha nismëtare e propozimit për dëgjuesën për ditën botërore të luftës kundër kancerit, në fakt, jam marrë pak me këtë punë dhe i kam propozuar ministres që të jetë prezente për vetë rëndësinë e çështjes që ne do që diskutojmë. Meqenëse është një çështje shumë sensitive, mendoj t'i bëjmë ftesë për të qenë prezente në dëgjuesë Aleancës së Grave Deputete dhe nënkomisionit që drejtohet nga zonja Gjermani. Duke pasur një prezencë më të gjerë nga ministria, por edhe nga ne si deputetë, duke dalë pak jashtë komisionit për këtë lloj problematike, meqenëse dita botërore kundër kancerit është në datën 4, mendoj që këtë dëgjuesë ta zhvillojmë ditën e hënë.

**Petrit Vasili** – Personalisht nuk kam asnjë koment për datën. Nëse nga ministria janë të gatshëm për datën 4, unë jam dakord, nëse jo, atëherë e lëmë për në datën 5. Duhet të respektojmë edhe axhendën e tyre.

**Klodiana Spahiu** – Çfarëdolloj propozimi që ju keni për të ftuar të gjithë aktorët që marrin pjesë me punën e tyre të përditshme në luftën kundër kancerit, duke u fokusuar më shumë te pjesa e shëndetit të gruas, meqenëse është java e kancerit të qafës së mitrës, mendoj se ia vlen të jenë pjesë e kësaj seance dëgjimore për të dhënë mendimet dhe opinionet e tyre.

Për sa u përket dy propozimeve tuaja, i konsideroj shumë të drejta. Keni ndonjë propozim konkret që kërkon në seancën dëgjimore të ditës së mërkurë patjetër ministren? Vetëm për çështje kohe ...

**Petrit Vasili** – Mendova që është e natyrshme për një arsye shumë të thjeshtë. Problemi krijon një ndjeshmëri të madhe publike. Jo në pak raste vetë ministrja është shprehur për sensibilitetin që kjo çështje ka. Prandaj, është gjëja më e natyrshme në botë që të jetë këtua. Nëse nuk do të ishte fizikisht në Shqipëri, do të gjenim një mundësi tjetër. Çështja është urgjente dhe nuk mund t'u kthejmë përgjigje të tjerëve. Kjo do të varet nga gatishmëria. Ju lutem sekretareve, Egla dhe Joana, që, sapo të mbarojmë mbledhjen, të komunikojnë menjëherë me Ministrinë e Shëndetësisë që ne po biem dakord për disa data. Në bazë të gatishmërisë së ministrisë, sapo të konfirmohet, nëse do të ketë ndryshime, do të dërgohen përsëri me *e-mail* datat e riazhornuara.

Në datën 30 do të zhvillohet seanca për tarifat, ditën e hënë do të zhvillojmë seancën për kancerin, nëse do të kemi gatishmëri, ditën e martë ...

*(Ndërrhyrje pa mikrofoni)*

Unë po them datat.

Në datën 5 do të diskutojmë për fruthin, kurse në datën 6 për ndihmën ekonomike.

Ndihma ekonomike është një problem i bartur. Ministria e Shëndetësisë ka paraqitur edhe informacion. Tani është vetëm problemi i diskutimit në komision. Problemi për tarifën është shumë i njohur, prandaj duhet të mbajmë vetëm një qëndrim publik. Për diskutimin për fruthin mund të mos vijë ministria, por le të vijë zëvendësministria apo drejtuesit e Shëndetit Publik. Për diskutimin për kancerin mund të lëvizim datat. Nëse e kanë të vështirë për të qenë prezentë, sipas gatishmërisë, rirregullojmë datat. Nuk kemi mundësi tjetër.

Në rast se do të kemi mungesë absolute, do të shtyjmë një nga diskutimet për ndonjë ditë tjetër. Tri çështjet më delikate janë: tarifat, kanceri dhe ndihma ekonomike, që është një çështje e bartur.

Është nënvizuar që për kancerin prezenca e ministres është e domosdoshme, për tarifat po ashtu, sepse është një çështje që e ka ndjekur vetë, kurse për të tjerat vendosim sipas gatishmërisë. Do të takohemi në mbledhjen e radhës dhe themi që për këto arsye do të rishikojmë datat apo do të shtyjmë një nga diskutimet. Besoj se kjo është zgjidhja më praktike.

**Klodiana Spahiu** – Për sa i përket diskutimit për ndihmën ekonomike ministria na është përgjigjur, por meqenëse kërkesa ishte bërë nga një anëtare e opozitës dhe opozita nuk merrte pjesë në mbledhjet e komisionit, ne menduam ta zhvillojmë diskutimin kur opozita të ishte prezente. Në fakt, nënkryetaria Spiropali ka kërkuar më parë që të ishte prezente edhe ministria. Kjo ka qenë arsyeja që e kemi shtyrë.

Mendoj që dëgjuesin për fruthin ta zhvillojmë në Institutin e Shëndetit Publik. Komisioni nuk ka lëvizur asnjëherë në institucione të shëndetësisë.

**Petrit Vasili** – Mund ta shikojmë edhe këtë sipas mundësisë praktike të realizimit të dëgjuesës. Rëndësi ka që të biem dakord për këto katër çështje. Për shkak të kohës në dispozicion nuk mendoj se ka mundësi objektive për të shtuar ndonjë gjë tjetër. Jemi dakord me këto katër çështje dhe me fleksibilitetin e datave? Nuk kemi pse të bëjmë interpretim. Nëse nuk kanë mundësi të marrin pjesë, e shtyjmë për një ditë tjetër. Komunikimi me ministrinë do të bëhet menjëherë pas mbledhjes në mënyrë që t'i jepet kohë të planifikojë punët e veta.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po.

Ramë dakord me axhendën.

Mbetet për t'u diskutuar ligji për nxitjen e punësimit, i cili është futur në program, por jo në kalendar. Nuk po e citoj, sepse nuk mund ta fusim në kalendar sot. Ka qenë një ligj që ne e morën, por e tërhoqi vetë ministria.

Ka diçka tjetër për të diskutuar?

Faleminderit të gjithëve!

**MBYLLET MBLEDHJA**